

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXV, nr. 8002  
E premte, 28 shkurt 2025  
Çmimi 0.50 €

Gjithmonë në shërbim të politikës, asnjëherë të integritetit intelektual | **FAQE 8**



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Na ndiqni edhe në:


[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## PO VAZHDON NUMËRIMI I VOTAVE TË DIASPORËS

FAQE 4-5



Në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve ka vazhduar të enjten numërimi i fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës, respektivisht nga votimi në përfaqësitë diplomatike. Më 8 shkurt 2025

është votuar në 30 përfaqësi diplomatike me gjithsej 43 vendvotime dhe, sipas të dhënave nga 20 324 votues të regjistruar, kanë votuar 75.57 % e tyre apo 15 352 shtetas të Kosovës që gjatë regjistrimit

kishin përzgjedhur këtë mënyrë votimi. Nga 44.19 për qind e vendvotimeve, Lëvizja Vetëvendosje po prin me 81.89 për qind apo 3 305 vota, e pasuar nga LDK-ja, PDK-ja dhe AAK-ja

**HOOPERI: KOSOVA DUHET TA BINDË SHBA-në TA VAZHDOJË MBËSHTETJEN PËR SOVRANITETIN E SAJ** **F. 4-5**



**DY VJET PAS MARRËVESHJES SË BRUKSELIT, KOSOVA DHE SERBIA NË PRAPAKTHIM** **F. 7**



**PORTOFOLI I KREDIVE TË GARANTUARA KA ARRITUR NË 850 MILIONË EURO** **F. 8**

**SPORT**



**REXHBEÇAJ PËR 'FIFA.COM': PËR KOSOVËN ÇDO GJË ËSHTË E MUNDUR** **F. 10**

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA** GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# DASH-i pas dënimit të Dodikut: Kundërshtojmë çdo veprim që do ta minonte sigurinë e Bosnjës

WASHINGTON, 27 SHKURT - Departamenti Amerikan i Shtetit tha se kundërshton çdo veprim të udhëheqësve lokalë në Bosnjë-Hercegovinë që do ta minonte sigurinë dhe stabilitetin e shtetit. Kjo deklaratë u bë nga zëdhënësja e DASH-it, Tammy Bruce, pasi Gjykata e Bosnjë-Hercegovinës e dënoi presidentin e entitetit të Republikës Sërpska, Millorad Dodik, me një vit burgim dhe gjashtë vjet ndalesë të ushtrimit të detyrës së presidentit. "Shtetet e Bashkuara kanë investuar për dekada për një Bosnjë-Hercegovinë stabile. Ne kundërshtojmë fuqishëm çdo veprim nga udhëheqësit lokalë që do ta minonte sigurinë dhe stabilitetin. Ne mbështesim Marrëveshjen e Dejtonit dhe sovranitetin dhe integritetin territorial të Bosnjë-Hercegovinës", shkroi në X zëdhënësja e DASH-it, Tammy Bruce. Dodiku është futur dy herë në listën e zezë amerikane për shkak të aktiviteteve të tij kundër Marrëveshjes së Paqes të arritur

në Dejton më 1995. Më 26 shkurt, gjykata në Bosnjë-Hercegovinë shqiptoi dënimin ndaj Dodikut për mosrespektim të vendimeve të përfaqësuesit të Lartë të bashkësisë ndërkombëtare, Christian Schmidt. Ndërkaq, i akuzuari i dytë në këtë rast, ushtruesi i detyrës së drejtorit të Gazetës Zyrtare të Republikës Sërpska, Millosh Llukij, u lirua nga akuzat. Ky është vendim i shkallës së parë ndaj të cilit Dodiku mund të ankohe. Dodiku është përballur me gjyq nën akuzat se kishte nënshkruar dekrete presidenciale përmes të cilëve kishte shpallur të vlefshme dy ligje jokushtetuese të Republikës Sërpska, që më parë ishin shfuqizuar nga përfaqësuesi i lartë. Bëhet fjalë për ligjet mbi moszbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Bosnjës dhe moszbatimin e vendimeve të përfaqësuesit të lartë në territorin e Republikës Sërpska. Në Kodin Penal të Bosnjës për mosrespektimin e vendimeve të

përfaqësuesit të lartë parashihet dënim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet burgim, si dhe mundësi të shkarkimit nga detyra të një individi dhe ndalimi i veprimtarisë politike. Pas shqiptimit të dënimit, Dodiku u tha mbështetësve të tij të mbledhur para Asamblesë Kombëtare të Republikës Sërpska se "nuk ka arsye për shqetësim". Ai, po ashtu, tha se Asambleja e entitetit serb do të ndërmarrë disa vendime, përfshirë atë që të refuzohet procesi në Gjykatën e Bosnjës dhe të "ndalohet puna e Prokurorisë në territorin e Republikës Sërpska". "Vendimi i dytë është ndalimi i zbatimit të vendimeve të Gjykatës së Bosnjë-Hercegovinës në territorin e Republikës Sërpska", tha Dodiku, duke paralajmëruar, po ashtu, se do të miratohet një ligj që do ta ndalojë veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial të Bosnjës dhe të formimit të këtyre institucioneve në nivel entiteti. Kundër dënimit të Dodikut janë shprehur udhëheqësit në Serbi



të cilët e kanë cilësuar si "sulm ndaj serbëve". Presidenti serb, Aleksandar Vuçiq, e ka cilësuar "të turpshëm, të paligjshëm dhe jodemokratik" vendimin e gjykatës së Bosnjës, i cili, sipas tij, synon "shkatërrimin e Republikës Sërpska dhe rrënimin e pozicionit të popullit serb". Ndërkaq, ministri i Brendshëm serb, Ivica Dačić, deklaroi pas një mbledhjeje të Këshillit të Sigurisë Kombëtare të Serbisë, se ky organ, me propozimin e Vuçiqit

ka miratuar shtatë konkluzione ku, ndër të tjera, dënohet vendimi i gjykatës, që cilësohet si "jodemokratik dhe i paligjshëm" dhe bëhet thirrje për respektimin e Marrëveshjes së Dejtonit dhe ndalimit të "shkatërrimit të mëtejshëm të sistemit" të krijuar nga ky dokument. Kundër dënimit të Dodikut ka reaguar edhe zëvendëskryeministri i Serbisë, Aleksandar Vulin, duke thënë se ky vendim është "sulm ndaj serbëve dhe Serbisë".

## Faza e parë e armëpushimit ndërmjet Izraelit dhe Hamasit përfundon gjatë fundjavës

JERUSALEM, 27 SHKURT - Izraelitët i dhanë lamtumirën një nëne të re dhe dy fëmijëve të saj të vegjël të cilët u vranë, ndërsa po mbaheshin peng nga Hamasi. Siç njofton korrespondentja e Zërit të Amerikës nga Tel Avivi, ceremonia mortore për ta u mbajt vetëm disa ditë para se faza e parë e armëpushimit ndërmjet Izraelit dhe grupit militant Hamas, të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara, po shkon drejt fundit pa një plan se si do të vazhdohet në fazën e ardhshme. Mijëra izraelitë u rreshtuan përgjatë rrugës për ta nderuar kortezhin e Shiri Bibas dhe dy djemve të saj të vegjël, të cilët u vranë gjatë kohës që po mbaheshin peng nga Hamasi. Shumë prej të pranishmëve mbanin në duar balona ngjyrë portokalli, simbol për fëmijët, flokët e të cilëve kishin këtë



ngjyrë. Një prej tyre ishte katër vjeç, ndërsa tjetri 9 muajsh. Mijëra të tjerë mbushën Sheshin e Pengjeve në Tel Aviv për t'i përkujtuar viktimat, shumë prej të cilëve mbanin pankarta me mbishkrimin "Na falni" në hebraisht. "Ndihe mi Shiri. Mund të kem qenë unë në vendin e saj. Mund të ketë qenë secila nga ne, çdo nënë. E

pamundur ta përfytyroj si mund të ketë qenë sikur të mbahesh peng me foshnjat e tua. As mund ta imagjinoj se çfarë ka kaluar ajo", thotë Chen Bachar, një nga pjesëmarrëset në ceremoni. Bashkëshorti dhe babai i pengjeve të vrara, Yarden Bibas, ishte në mesin e pengjeve të liruara para dy javësh nga Hamasi pasi ishte

mbajtur për 500 ditë peng. Ai nuk dinte asgjë për fatin e familjes së tij deri në momentin kur u kthye në Izrael. Ceremonia mortore, e mbushur me emocione, u mbajt vetëm disa ditë para se të përfundojë faza e parë e armëpushimit ndërmjet Izraelit dhe Hamasit këtë fundjavë. Faza e dytë synon t'i japë fund luftës në Gazë, por negociatat për këtë fazë ende nuk kanë filluar. Përkundër zemërimit të gjerë për vrasjen e familjes Bibas, shumica e izraelitëve përkrahin vazhdimin e negociatave, sipas analistëve izraelitë. "Gjithë anketat e realizuara me publikun izraelit tregojnë një dëshirë të fortë për ta vazhduar armëpushimin, të paktën derisa pengjet e mbetura, rreth 30 burra që janë ende gjallë, të lirohen, si dhe të kthehen trupat e pajetë të

ushtarëve dhe pengjeve të tjera", thotë profesoresha e shkencave politike Sara Hirschhorn nga Universiteti i Haifës. Por kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu i është referuar vazhdimisht tragjedisë së familjes Bibas për ta mbështetur rifillimin e luftës në Gazë. "Vendi është i bashkuar në dhimbje dhe si kryeministër i Izraelit zotohem se nuk do të ndalem derisa bishat që ekzekutuan pengjet tona të vihen para drejtësisë. Nuk e meritojnë të ecin në këtë tokë. Asgjë nuk do të mund të më ndalë", deklaroi ai. Analistët thonë se shumica e izraelitëve duan një marrëveshje armëpushimi me Hamasin deri në lirimin e të gjitha pengjeve. Por në një periudhë afatgjatë, shumica e izraelitëve thonë se nuk duan që Hamasi të vazhdojë ta ketë kontrollin mbi Gazën.

## Shkurtimi i vendeve të punës, Musk: Kam marrë kërcënime me vdekje!

WASHINGTON, 27 SHKURT - Teksa paralajmëroi në takim të kabinetit të presidentit Donald Trump se do të ketë pasoja të rënda financiare nëse masat e tij për uljen e kostove dështojnë, Elon Musk pohoi se ka marrë kërcënime të shumta me vdekje. Miliarderit u shfaq në takim me një kapelë të zezë "Make America Great Again".

Musku e përshkroi rolin e tij si "mbështetje teknologjike" për qeverinë federale si kreu i Departamentit të Sapokrijuar të Efikasitetit të Qeverisë (DOGE). "Ne si vend, thjesht nuk mund ta mbajmë barrën e një deficiti prej 2 trilionë dollarësh. Pagesat e interesit për borxhin kombëtar aktualisht i kapërcejnë shpenzimet vjetore të mbrojtjes. Nëse kjo vazhdon,

vendi de facto shkon drejt falimentimit. Kjo është arsyeja që unë jam këtu dhe marr shumë kërcënime me vdekje, meqë ra fjala", tha Musk. Trumpi e lejoi Muskun ta dominonte pjesën më të madhe të takimit dhe vlerësoi punën e tij, duke thënë se ekipi i vet kishte zbuluar "gjëra të tmerrshme" brenda qeverisë. "Ai po sakrifikon shumë", u

shpreh Trumpi, duke iu referuar kohës së Muskut larg sipërmarrjeve të tij të shumta të biznesit. Masat e ashpra të manjatis për uljen e kostove kanë ngjallur polemika të shumta. Gjatë fundjavës punonjësit federalë morën një email nga Zyra e Menaxhimit të Personelit, që i udhëzonte të dorëzonin raporte të hollësishme të punës së tyre.



## Osmani takon organizatat joqeveritare, diskutojnë për themelimin e Komisionit për Drejtësinë Tranzicionale

PRISHTINË, 27 SHKURT - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të enjten në takim përfaqësues të disa organizatave joqeveritare në Kosovë, me të cilët ka diskutuar rreth përgatitjeve për themelimin e Komisionit Presidencial për Drejtësinë Tranzicionale.


Themelimi i këtij Komisioni rrjedh nga Strategjia për Drejtësinë Tranzicionale e Republikës së Kosovës, ndërsa procesi i funksionalizimit të tij do të vazhdojë në javët në vijim, në bashkëpunim me organizatat përfaqësuese të viktimave të luftës në Kosovë, shoqërinë civile dhe partnerët

ndërkombëtarë. Presidentja Osmani shprehu mirënjohje për mbështetjen dhe angazhimin e organizatave joqeveritare në proceset që lidhen me drejtësinë tranzicionale dhe i falënderoi të pranishmit për gatishmërinë e tyre për të kontribuar në këtë proces.



# PO VAZHDON NUMËRIMI I VOTAVE TË DIASPORËS

Në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve ka vazhduar të enjten numërimi i fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës, respektivisht nga votimi në përfaqësitë diplomatike. Më 8 shkurt 2025 është votuar në 30 përfaqësi diplomatike me gjithsej 43 vendvotime dhe, sipas të dhënave nga 20 324 votues të regjistruar, kanë votuar 75.57 % e tyre apo 15 352 shtetas të Kosovës që gjatë regjistrimit kishin përzgjedhur këtë mënyrë votimi. Nga 44.19 për qind e vendvotimeve, Lëvizja Vetëvendosje po prin me 81.89 për qind apo 3 305 vota, e pasuar nga LDK-ja, PDK-ja dhe AAK-ja



pati edhe diaspora jonë, e cila për herë të parë, përveç votimit me postë, pati mundësinë të votojë edhe në ambasada dhe konsullatat tona. Falënderoj bashkatdhetarët që morën pjesë në këto zgjedhje, qoftë përmes votimit nga jashtë, qoftë duke udhëtuar në Kosovë për të votuar, duke u bërë ashtu edhe siç janë - pjesë e pandashme e vendimmarrjes për vendin tonë", ka thënë Kurti.

Sipas rezultateve preliminare, Lëvizja Vetëvendosje (LV) ka dalë e para në këto zgjedhje me 40.90 për qind të votave. Ndonëse ende nuk janë numëruar votat me kusht, ato të personave me nevojë të veçanta dhe votat e diasporës, kjo parti nuk e ka siguruar shumicën e nevojshme për formim të qeverisë.

E dyta ka dalë Partia Demokratike e Kosovës me 22.05 për qind. E treta ka dalë Lidhja Demokratike e Kosovës me 17.64 për qind të votave, pasuar nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me 7.46 për qind të votave të fituara. Nga partitë e komunitetit serb, më së shumti vota ka marrë Lista Serbe, përkatësisht 4.62 për qind.

Analistët politikë kanë përmendur mundësinë e bashkimit të forcave të LV-së me komunitetet joserbe, që i kanë 10 ulëse të garantuara në Kuvend.

Partitë opozitare, Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës, dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, kanë hedhur poshtë mundësinë e krijimit të koalicionit me LV-në dhe kanë shprehur gatishmëri për formimin e një qeverie së bashku.

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 SHKURT - Në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) po vazhdon numërimi i fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës, respektivisht nga votimi në përfaqësitë diplomatike. Deri të mërkurën në mesnatë janë numëruar 19 nga 43 vendvotime, ndërkaq procesi i numërimit është duke vazhduar për pjesën e mbetur të vendvotimeve. Më 8 shkurt 2025 është votuar në 30 përfaqësi diplomatike me gjithsej 43 vendvotime dhe, sipas të dhënave nga 20 324 votues të regjistruar, kanë votuar 75.57 % e tyre apo 15 352 shtetas të Kosovës që gjatë regjistrimit kishin përzgjedhur këtë mënyrë votimi. Nga 44.19 për qind e vendvotimeve, Lëvizja Vetëvendosje prin me 81.89 për qind apo 3 305 vota. Në vendin e dytë është Lidhja Demokratike e Kosovës me 291

vota, apo 7.21 për qind. Partia Demokratike e Kosovës ka fituar 5.75 për qind apo 232 vota, pasuar nga koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Nisma Socialdemokrate, Konservatorët e Intelktualët me 1.54 për qind apo 62 vota.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka theksuar se procesi i numërimit është transparent dhe në prani të vëzhguesve. Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, tha se "është e pamundur të thuhet se sa do të zgjasë numërimi", por se rezultatet do të publikohen sapo të kenë përfunduar numërimet e vendvotimeve - si ato të subjekteve politike, ashtu edhe ato të kandidatëve për deputetë.

Në konferencën për medie, Elezi tha se në këto vendvotime janë ndjekur të njëjtat procedura të sigurisë si në vendvotimet në Kosovë për ta siguruar integritetin e zgjedhjeve. Përfaqësues të partive politike

dhe të shoqërisë civile në Kosovë janë ankuar për kohëzgjatjen e procesit të numërimit dhe verifikimit të votave, por KQZ-ja ka insistuar se po ruan integritetin e votave dhe se po i jep prioritet saktësisë para shpejtësisë.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të mërkurën, në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës, se Lëvizjes Vetëvendosje i takon t'i formojë institucionet në legjislaturën e nëntë. "Kemi hyrë në fazën finale të procesit të numërimit të votave për zgjedhjet e 9 shkurtit. Sot fillon numërimi i votave të diasporës. Sipas njoftimeve të Komisionit Qendror Zgjedhor, më së largu deri në javën tjetër pritet të kemi rezultatet përfundimtare për subjektet politike. Si fitues

të qartë të këtyre zgjedhjeve, nga ne qytetarët presin që sa më parë ta përmblim obligimin që na takon për formimin e institucioneve në legjislaturën e 9. Deri atëherë nga ju, të nderuar kabinet qeveritar, kolegje, pres që ta vazhdoni punën dhe punët e mira me po të njëjtin ritëm", ka thënë Kurti.

Ai ka thënë se të gjithë presin nga Komisioni Qendror Zgjedhor edhe më shumë angazhim për përfundimin e procesit të numërimit dhe kujdes të shtuar në mbrojtjen e vullnetit të votuesve për të përmbyllur kësaj një proces zgjedhor të lirë, të rregullt, të ndershëm e demokratik, me pjesëmarrje masive të qytetarëve. "Pjesëmarrje më të lartë ndonjëherë në zgjedhje

## Miratohet buxheti i komunës së Gjilanit për vitin 2025

GJILAN, 27 SHKURT - Është miratuar buxheti i komunës së Gjilanit në vlerë rreth 40 milionë euro pas shtatë muajsh zvarritjeje. Miratimi i buxhetit është vlerësuar hap i rëndësishëm për komunën. Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, tha se sot pas shumë përpjekjesh dhe diskutimesh, arritën ta miratojnë buxhetin e komunës sonë për vitin 2025

me vlerë rreth 40 milionë euro. "Ky është një moment i rëndësishëm për qytetin tonë, pasi ky buxhet do të jetë në shërbim të qytetarëve pa dallim, duke mundësuar investime dhe zhvillim për Gjilanin që duam", tha Alban Hyseni.

I pari i komunës tregoi se, fatkeqësisht, në buxhetin e miratuar nuk është përfshirë projekti i bulevardit të qytetit në vlerë prej 20 milionë

eurosh. Ky projekt, i cili do të kishte një ndikim të madh në infrastrukturën dhe zhvillimin urban të Gjilanit, është larguar nga opozita gjatë diskutimeve të së enjtes.

Mungesa e tij do të thotë një mundësi e humbur për modernizimin e hapësirave publike, lehtësimin e qarkullimit dhe krijimin e një mjedisi më të mirë për qytetarët. "Pavarësisht kësaj,



ne mbetemi të përkushtuar për të punuar që projekte të rëndësishme si ky të gjejnë

mbështetje dhe të realizohen në të ardhmen", tha kryetari i Gjilanit, Alban Hyseni.



## HOOPERI: KOSOVA DUHET TA BINDË SHBA-NË TA VAZHDOJË MBËSHTETJEN PËR SOVRANITETIN E SAJ

**PRISHTINË, 27 SHKURT** - Ish-diplomati amerikan James Hooper thotë në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë" se gjëja e parë që duhet të bëjë Qeveria e Kosovës është t'i riparojë marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara. Pa ndodhur kjo, sipas tij, do të ishte rrezik që ShBA-ja të përfshihej në përpjekjet e Kosovës për të arritur marrëveshje me Serbinë. "... sepse, shikoni, Shtetet e Bashkuara nuk po i ndihmojnë Ukrainës. Tash kur ato janë përfshirë në [zgjidhjen e atij konfliktit], ato janë rreshtuar në anën e autokratit, në anën e Rusisë, e jo në anën e demokracisë së vërtetë", thotë Hooperi. Shtetet e Bashkuara i kanë tërhequr disa herë vërejtjen qeverisë së udhëhequr nga Albin Kurti për shkak të disa veprimeve - që ato i kanë konsideruar si të pakoordinuara - në veriun e Kosovës të banuar me shumicë serbe. Me ato lëvizje, zyrtarët amerikanë kanë

thënë se Kosova ka vënë në pikëpyetje partneritetin mes dy vendeve. "Kosova duhet të komunikojë më mirë me Uashingtonin dhe të mos i japë leksione Uashingtonit", thotë njohësi i zhvillimeve në Ballkan, Hooper. Sipas tij, "është shumë e rrezikshme për Kosovën kur amerikanët e shohin atë si problem".

*Z. Hooper, si e komentoni ndryshimin e politikës amerikane ndaj Ukrainës, nën presidentin Donald Trump?*

**James Hooper:** Mua, personalisht, nuk më pëlqen. Mendoj se kjo e minon NATO-n, ndërsa NATO-ja ka qenë vendimtare për ruajtjen e paqes në Evropë, që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore, apo që nga fundi i viteve 1940. Unë kam respekt të madh për Ukrainën. Ukrainasit kanë luftuar shumë, e kanë befasuar botën dhe kanë nevojë për mbështetjen tonë. Ata kanë nevojë për mbështetjen e Amerikës. NATO-

ja nuk ka të bëjë vetëm me tanke, me avionë, me [raketa] Himars e me gjëra si këto. NATO-ja është vërtet besimi në fuqinë e Amerikës, në qëllimin dhe në vendosmërinë e saj. Presidenti Trump e minon këtë kur del në anën e presidentit Putin.

*Çfarë parashikoni të dalë nga kjo?*

**James Hooper:** Unë nuk mendoj se do të ketë zgjidhje të problemit. Problemi është se Rusia e do Ukrainën. Ukraina e ka përvojën e të qenët pjesë e Rusisë, në kuadër të Bashkimit Sovjetik. Dhe ajo ka qenë një përvojë e tmerrshme për të. Kështu që nuk do të pranojë të bëhet sërish pjesë e Rusisë. Nuk ka mundësi për ndonjë marrëveshje që do ta bënte Ukrainën pjesë të Rusisë. Mund të marrësh pjesë të Ukrainës dhe t'ia bashkohësh Rusisë - gjë të cilën Rusia e do dhe po përpjeket t'i bindë amerikanët ta pranojnë në mënyrë implicite ose

eksplicite. Ajo do të preferonte që amerikanët ta pranonin në mënyrë eksplicite, por nëse ata e pranojnë në mënyrë implicite, si diçka që është për keqardhje, por e nevojshme për paqen, atëherë ky është një plan i mirë B për Putinin - edhe pse ai do të preferonte të kishte marrëveshje formale.

**"Kosova t'i riparojë marrëdhëniet me ShBA-në"**

*A mund të sinjalizojë e gjithë kjo një ndryshim më të gjerë në politikën e jashtme të ShBA-së, përfshirë edhe qasjen e saj ndaj mosmarrëveshjes Kosovë - Serbi?*

**James Hooper:** Mosmarrëveshja Kosovë - Serbi është tjetër gjë dhe është shumë e rëndësishme që të pyesni për këtë. Mendoj se është shumë e rrezikshme që Kosova t'i përfshijë Shtetet e Bashkuara në përpjekjet e saj për të arritur marrëveshje me Serbinë sepse, shikoni, Shtetet e

Bashkuara nuk po i ndihmojnë Ukrainës.

Tash kur Shtetet e Bashkuara janë përfshirë në [zgjidhjen e konfliktit në] Ukrainë, ato janë rreshtuar në anën e autokratit, në anën e Rusisë, e jo në anën e demokracisë së vërtetë. Pra, është shumë vështirë që kosovarët të presin se Shtetet e Bashkuara do t'u vijjnë në ndihmë ose do t'i ndihmojnë në të njëjtën mënyrë siç i kanë ndihmuar [mbi] 20 vjet më parë në luftën me Serbinë.

Unë, thjesht, nuk e shoh se kjo mund të ndodhë. Plus, është e rrezikshme për Kosovën që Shtetet e Bashkuara të përfshihen tani, sepse kryeministri [i Kosovës, Albin] Kurti i ka dëmtuar seriozisht marrëdhëniet e Kosovës me ShBA-në. Dhe derisa kjo marrëdhënie nuk riparohet, përfshirja e ShBA-së nuk do të jetë ndihmesë për Kosovën. Kështu që, gjëja e parë që duhet të bëjë kryeministri Kurti - nëse do që t'i përfshijë Shtetet e

Bashkuara - është t'i riparojë marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara dhe më pas t'i përfshijë ato.

*A mund të ecë Kosova përpara pa shtytjen e ShBA-së?*

**James Hooper:** Po, mendoj se është e mundur. Këtu ka një pyetje strategjike. A mund të sigurojë Kosova marrëveshje më të mirë, duke e negociuar atë vetë, direkt me Serbinë? Apo do të sigurojë marrëveshje më të mirë nëse ShBA-ja është e përfshirë? Kjo është një çështje strategjike për të cilën duhet të vendosë Kosova.

Unë nuk mendoj se është e mundur që Kosova të arrijë një marrëveshje që i zgjidh të gjitha problemet e saj me Serbinë, pa përfshirjen e Shteteve të Bashkuara. Pajtohem me këtë. Por, Kosova mund të arrijë qëllime më të vogla - edhe pse shumë të rëndësishme - nëse negocion drejtpërdrejt me Serbinë.

Nëse kryeministri Kurti do të fokusohet në përfundimin e konfrontimit, mendoj se është e mundur që ai të negociojë drejtpërdrejt me Serbinë dhe të ketë sukses në këtë.

### "Kosova s'do të jetë prioritet i lartë" i administratës Trump

*A mendoni se administrata e re amerikane do t'i qaset mosmarrëveshjes Kosovë-Serbi? Sa lart do të jetë ajo në prioritetet e saj?*

**James Hooper:** Do të jetë një prioritet i ulët. Sekretari i Shtetit, Marco Rubio, nuk ka përvojë në Ballkan, ndaj nuk mendoj se do të jetë fokusi i tij. Nëse do të kishite ndonjë krizë, siç ka ndodhur disa muaj më parë, kur është dukur se ekziston rreziku i sulmit të Serbisë përtej kufirit, Shtetet e Bashkuara do të mund të ndërhyjnë. E nëse Shtetet e Bashkuara përfshihen, atëherë do të kishit avantazhin ose rrezikun e një zgjidhjeje të imponuar - një zgjidhjeje të imponuar nga Shtetet e Bashkuara. Unë mendoj se Kosova duhet të mendojë me shumë kujdes për këtë - nëse dëshiron të ketë një zgjidhje të imponuar amerikane. Por, unë mendoj se Kosova duhet ta shqyrtojë edhe nëse është më mirë për interesat e saj që të negociojë drejtpërdrejt me Serbinë. Unë vetë besoj se do të ishte më mirë që Kosova të negocionte drejtpërdrejt me Serbinë për t'i dhënë fund konfrontimit. E përsëris Kosova nuk do të mund ta sigurojë njohjen nga Serbia duke negociuar drejtpërdrejt me të, sepse Serbia nuk do ta njohë Kosovën derisa ajo të pranohet si anëtare e BE-së. Dhe kjo nuk do të ndodhë shpejt, me aq sa kuptoj BE-në dhe synimet e saj. Por, ka një sërë gjërash që udhëheqësit e Kosovës mund t'i

bëjnë. Gjëja më thelbësore është t'i riparojë marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara. Rregullojeni atë marrëdhënie përpara çdo gjëje tjetër!

Së dyti, mendoj se ata duhet të zhvillojnë marrëdhënie të mirë, solide me shefen e politikës së jashtme të BE-së, Kaja Kallas. Ajo është nga Estonia. Estonia është një shtet i vogël, i cili ka qenë nën kontrollin e Bashkimit Sovjetik. Pra, e di se si është të jesh i pushtuar nga një fuqi armiqësore. Ndaj mendoj se Kallasi do të jetë dashamirëse, ose së paku do ta kuptojë situatën në Kosovë. Dhe, së treti, kryeministri Kurti duhet të zhvillojë një marrëdhënie me presidentin [Aleksandar] Vuçiq të Serbisë.

*Por, a mendoni se Serbia do të pranonte të angazhohej drejtpërdrejt me Kosovën?*

**James Hooper:** Po. Pse nuk do të pajtohej? Mes [ish-presidentit të Kosovës, Hashim] Thaçi dhe presidentit të Serbisë, Vuçiq, ka pasur një marrëdhënie komunikimi dhe ka qenë shumë produktive. Ndoshta disa kosovarë janë kritikë dhe nuk pajtohen me mua, por ajo ka qenë një marrëdhënie produktive. Nuk i ka bërë miq, por i ka bërë të mësojnë se si të merren me njëri-tjetrin dhe si të komunikojnë me njëri-tjetrin. Tani unë nuk mendoj se z. Vuçiq ka ndonjë pëlqim të veçantë apo ndonjë respekt të veçantë për z. Kurti. Dhe nuk mendoj se z. Kurti ka ndonjë respekt të veçantë për zotin Vuçiq. Unë mendoj se ai e sheh Serbinë si armike të përhershme të Kosovës dhe ai dëshiron që populli i Kosovës të pajtohet me këtë dhe shumëkush pajtohet. Ai, po ashtu, do që bashkësia ndërkombëtare ta mbështesë Kosovën dhe ta mbrojë atë nga armiku i saj - pra ta trajtojë Serbinë si armike. Unë nuk mendoj se komuniteti ndërkombëtar do ta bëjë këtë. Nuk mendoj se është dakord me z. Kurti për këtë.

Por, unë mendoj se është plotësisht e mundur që Kosova të ketë marrëdhënie me Serbinë, e cila nuk është marrëdhënie miqsh, por fqinjësh. E vetmja mënyrë për ta arritur këtë, sipas mendimit tim, është që udhëheqja e Kosovës të zhvillojë një kanal komunikimi me z. Vuçiq.

*E thatë disa herë se Qeveria e Kosovës duhet t'i përmirësojë marrëdhëniet e saj me Shtetet e Bashkuara. Si?*

**James Hooper:** Qeveria e Kosovës duhet të komunikojë, duhet të mësojë se si të komunikojë në mënyrë më efektive me Uashingtonin. Tani për tani qeveria amerikane e konsideron kryeministrin Kurti si kokëfortë, të paaftë për të negociuar dhe ngatërrestar. Është shumë e rrezikshme për Kosovën kur amerikanët e



shohin atë si problem.

Kosova duhet të ketë një marrëdhënie më të mirë, pra të komunikojë më mirë me Uashingtonin dhe të mos i japë leksione Uashingtonit.

Unë mendoj se amerikanët besojnë se Qeveria e Kosovës po përpiqet të krijojë probleme me Serbinë. Unë e di se Serbia nuk është e pafajshme në këtë situatë dhe se, ndonjëherë, do që të krijojë probleme me Kosovën. Por, është e rrezikshme që amerikanët të besojnë se Kurti është ngatërrestari kryesor në Ballkan, që dëshiron të krijojë probleme me Serbinë, të cilat mund ta kërkojnë ndërhyrjen e Shteteve të Bashkuara dhe NATO-s. Shtetet e Bashkuara nuk duan të ndërhyjnë ushtarakisht në një situatë krize në Kosovë. Dhe nuk mendoj se Kosova duhet të supozojë se Shtetet e Bashkuara do të ndërhyjnë.

*A mendoni se përkushtimi i Uashingtonit ndaj sovranitetit të Kosovës do të mbetet po aq i fuqishëm sikurse më parë?*

**James Hooper:** Ajo që mund të thuhet për [ish-presidentin amerikan, Joe] Biden, është se ai ka pasur njohuri për Ballkanin. Si senator, ai ka qenë shumë i përfshirë në Ballkan - qoftë me Kosovën, qoftë me Bosnjë-Hercegovinën. Dhe, mendoj se mbështetja e tij për sovranitetin e Kosovës ka qenë shumë e fortë. Nuk mund të imagjinoj ndonjë më të fortë. Unë nuk do të pretendoja se mbështetja e Amerikës për sovranitetin e Kosovës do të vazhdojë. Me siguri se do të vazhdojë, por unë nuk do ta bëja atë supozim. Kosova duhet të punojë më shumë për t'i bindur amerikanët që të përfshihen në mënyrë aktive dhe të angazhohen në mënyrë aktive. Ky është vërtet mesazhi im, që Kosova nuk duhet të supozojë asgjë rreth Shteteve të Bashkuara, por duhet të punojnë për ta siguruar mbështetjen e tyre.

*Nëse ShBA-ja do të kishte një*

*qasje më transaksionale - siç thonë tani për presidentin Trump - çfarë do të mund t'i kërkonte Kosovës në atë rast? A do të mund të përballet Kosova me presion për të bërë ndonjë koncesion territorial apo politik?*

**James Hooper:** Një marrëveshje transaksionale mund të nënkuptojë që amerikanët presin nga kosovarët të bëjnë lëshime politike. Ndoshta edhe territoriale... por mendoj koncesione politike.

*A keni diçka konkrete në mendje?*

**James Hooper:** Nuk dua të jem i padrejtë ndaj presidentit Trump... Së pari, ai nuk e kupton Ballkanin, nuk është përpjekur kurrë që ta kuptojë dhe nuk pretendon se e kupton. Nuk është një element kryesor i politikës së tij ndaj Evropës. Është përgjegjësi e Qeverisë së Kosovës që ta ndihmojë presidentin Trump që të kuptojë më mirë Ballkanin.

*Çfarë hapash duhet të ndërmerret Kosova për t'i mbrojtur interesat e saj?*

**James Hooper:** Mendoj se Kosova ka nevojë për një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me Serbinë, të cilën nuk e ka tani. Nëse nuk mund të llogaritet automatikisht se ShBA-ja dhe NATO-ja do ta mbrojnë Kosovën në çdo situatë krize, atëherë Kosova duhet të sigurohet që të mos ketë kriza dhe duhet t'i parandalojë ato, sepse çdo përshkallëzim i situatës do të kërcënonte pavarësinë e Kosovës.

Unë mendoj se Kosovës i duhet një strategji, kryeministrin i duhet një strategji. Dhe strategjia duhet të jetë anëtarësimi i Kosovës në NATO. Sigurisht që Kosova dëshiron të jetë në NATO dhe të gjithë e dinë këtë. Por, nuk mendoj se Kosova e di se si të futet në NATO. Nuk është e lehtë, por kjo është ajo që Kosovës i duhet shumë - të jetë pjesë e NATO-s. Mendoj se është më e rëndësishme për Kosovën

që të jetë pjesë e NATO-s sesa e BE-së. Populli i Kosovës duhet ta shohë si përgjegjësi të kryeministrin Kurti që të negociojë, të gjejë një mënyrë, një rrugë për ta futur Kosovën në NATO. Ky duhet të jetë qëllimi.

*Mendoni se Kosova tani nuk është duke punuar drejt atij qëllimi?*

**James Hooper:** Po, por nuk është efektive. Çdokush e di se Kosova dëshiron të bëhet pjesë e NATO-s, nuk po zbuloj ndonjë të vërtetë të fshehtë, por problemi është se ju nuk mund të hyni në NATO duke i dëmtuar marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara. Sepse, nëse Shtetet e Bashkuara duan që Kosova të jetë në NATO, ajo do të jetë në NATO. Edhe pse disa nga vendet e NATO-s nuk e duan këtë... nëse amerikanët duan që të ndodhë, do të ndodhë. Ky është realiteti. Siç e them unë, NATO-ja është besimi në fuqinë, qëllimin dhe vendosmërinë amerikane. Dhe shtetet e tjera anëtare të NATO-s e kuptojnë rolin e rëndësishëm që luajnë Shtetet e Bashkuara - së paku rolin e rëndësishëm që kanë luajtur deri më tani. Në të ardhmen, do të shohim. Por, është përgjegjësi e Qeverisë së Kosovës që të zhvillojë një strategji, për të ecur drejt anëtarësimit në NATO dhe për t'i bindur Shtetet e Bashkuara se është në avantazhin e tyre që Kosova të jetë në NATO.

*Kosova nuk e ka ende qeverinë e re - pas zgjedhjeve të 9 shkurtit - por cilat mendoni se duhet të jenë prioritetet e saj kur të formohet dhe pavarësisht se kush e formon atë?*

**James Hooper:** Anëtarësimi në NATO. Prioriteti i dytë duhet të jetë përfundimi i konfrontimit me Serbinë. Përfundimi i këtij konfrontimi e bën Kosovën gjithashtu kandidatë më atraktive për anëtarësim në NATO, dhe është një gjë që mund të bëhet. Të dyja këto ndërliken - nëse e ke njërin, është më lehtë ta arrish tjetrin.

# GJITHMONË NË SHËRBIM TË POLITIKËS, ASNJËHERË TË INTEGRITETIT INTELEKTUAL



Behxhet Sh.  
SHALA - BAJGORA

**Qeveria Kurti apo Kurthi 3:** E kemi një situatë bukur të ndërlikuar, është një luftë e egër për pushtet kur Kosova po hyn në një labirint thuaja pa dalje. LV-ja deri më tani ka siguruar 47 deputetë dhe pas votave të diasporës, në rastin më të mirë mund t'i ketë 50 mandate për çka nuk jam fort i bindur. LV-ja e ka çështje të mbijetesës të sigurojë edhe një mandat, ndërsa jam fort i sigurt se kjo kohë është koha më e keqe për të qeverisur sepse thuaja asgjë më nuk është në dorën tonë. Jemi dëshmitarë se si Trampi e zhduku Ukrainën, si mbi varret e mbi 80 000 civilëve të vrarë në Rripin e Gazës planifikon të ndërtojë hotele, qendra tregtare dhe bordele, në kundërshtim me çdo parim a moral elementar njerëzor. Prej se kam filluar të marr pak vesh në politikë gjithmonë kam qenë me republikanët në ShBA, jam edhe tash, por jo edhe me Trampin. Isha me Trampin deri në kohën kur arrogancën e bëri parim moral, dhunën e shndërroi në ligj, kurse bashkëpunimin ekonomik e shndërroi në gjobëvënie dhe haraç. Grenellin e ka emëruar emisar për kriza në të gjitha vendet e botës, kurse Kosovën i ka lënë ta përdorë në vend të vitrave. Ishte ndërhyrje e pashembullt dhe jodiplomatike para zgjedhjeve të 9 shkurtit 2025. Edhe po t'i kishte Albin Kurti të gjitha ato që i thotë Grenelli, nuk është dashur të reagojë aq anshëm dhe aq brutalisht siç reagoi. Asgjë nuk e ka dobësuar Kurtin, ndërkaq që do të detyrohet, edhe të takohet, edhe të bashkëpunojë me Kurtin, qoftë si kryeministër, qoftë si lider i opozitës së ardhshme. Po flitet se Grenelli mund ta vizitojë Kosovën javën që vjen dhe, nëse vjen me qëndrim sikur që e kishte para zgjedhjeve, aspak nuk gëzohem për këtë vizitë, nuk pajtohem me qëllimin që të na dorëzojë vendimin, pa drejt

ankese!  
Me Albin Kurtin nuk pajtohem thuaja me asgjë, për mua ka dështuar të jetë një menaxher i mirë sepse është shndërruar në autokrat, kurse qeverisjen e mirë e ka shndërruar në një regjim autoritar, në diktaturë. Mirëpo kjo nuk është arsye që Albini të linçohet si anti-amerikan apo anti-evropian kur janë njëqind mijë arsye dhe mundësi të kundërshtohet brenda për dështimet në planin ekonomik, social, politik, zhvillimor dhe kombëtar. Opozita nuk duhet të lakmojnë që ta bëjnë qeverinë, edhe nëse iu krijohen mundësitë aq më parë duke shkuar: "pas koçe... të Grenellit..". Nëse opozita nuk hynë në qeveri me Kurtin, në planin afatshkurtër e humbë pushtetin, strategjikisht fiton shumë. Nëse PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja nuk pranojnë koalicion me Kurtin, në mënyrë konstruktive do të kontribuojnë në rrënimin politik të Kurtit (është zgjedhje e tij) sikur që Nisma, që po lakmon të bëhet pjesë e qeverisë do ta relativizojë duke e shndërruar në mendermethënë Guxo dhe Alternativa e zemlakes së Radoiçiqit. Fatmir Limën me asnjë parti nuk e pranon në koalicion, do të shkrihet në LV duke e ruajtur emrin. Është vendim dhe llogari e tij, ndoshta i del mirë! Albin Kurtit duhet t'i ndihmohet ta bëjë qeverinë Kurti 3 e cila pastaj do të merrej me Trampin, Grenellin, Maskun etj. Pse duhet të merret opozita me ta, nuk ka asnjë përgjegjësi. Kush e do pushtetin absolut, edhe përgjegjësia e ka absolute sikur edhe pasojat. Qeveria Kurti 3, bashkë me Limajn maksimumin e mandateve mund t'i ketë 51- deputetë, plus 10 deputetë të pakicave joserbe. Është qeveri buzë greminës, mund të shembet në çdo kohë. LV-ja po kundërshton koalicionin me Listën Serbe, në emër të patriotizmit që nuk e ka. Mirëpo jam i sigurt se me ardhë koha me e rrahë pyka - pykën, LV-ja do t'i pranojë votat e Listës Serbe sikur në kohën kur ishte votuar Sherife Osmani presidente apo kur me votat e Listës Serbe ishte refuzuar rroga minimale për veteranët e luftës ku kishte ndërmjetësuar Lakuriqja e Natës, Mimoza Kusari. Unë e shoh një tjetër skenar. Nëse

çështja e Kosovës nuk ka qenë pjesë e pakos Tramp - Putin, atëherë do të imponohet një koalicion i gjerë që të sigurohet një vendimmarrje e gjerë dhe përgjegjësia do të ndahej te të gjithë partnerët e koalicionit. Partitë opozitare e as LV-ja nuk kanë guxim ta kundërshtojnë një propozim të tillë sidomos nëse vjen: "një ofertë që nuk mund të refuzohet..". Këtë ofertë e pati edhe Zelenski, e kundërshtoi në fillim, nesër e nënshkruan në Shtëpinë e Bardhë pasi Zelenski e ka vetëm lapsin për nënshkrim kurse Tramp në një dorë e ka lapsin, kurse në tjetrën e ka koltin të kalibrit 36 mm që i siguron një: "ofertë që nuk mund të refuzohet..". Kur të vjen koha e presidentit nuk nënkupton shkuarja në zgjedhje të parakohshme automatikisht. Dëgjova se Kurti nëse e ka qeverinë e pakicës, në kohën kur do të votohet për presidentin mund ta luajë lojën duke dalë, sipas tij me: "një propozim që nuk mund të refuzohet - Murat Jashari". Edhe në zgjedhjet paraprake Kurti manipulonte me një anëtar të familjes Jashari për president, sigurisht në Murat Jasharin. Në fund doli se përfaqësuesi më i denjë për president nga familja Jashari ishte Vjosa Osmani. Po edhe nëse Kurti do ta vë në riqarkullim emrin e Murat Jasharit për president, opozita nuk e ka asnjë detyrim ta votojë atë për faktin se janë rreshtuar politikisht pas LV-së dhe kanë dalë kundër partive tjera në vend se ta ruajnë neutralitetin.

**Intelektualë pa integritet profesionalë, moral, politik dhe kombëtar:** Pse ne shqiptarët jemi ku jemi në të gjitha trojet ku jetojmë, faji është te mungesa e arsimit kombëtar, mungesa e intelektualëve që i shërbejnë kombit dhe shtetit. Në Shqipëri pas përfundimit të luftës së dytë botërore, Enver Hoxha i vrau, burgosi, i internoi apo i përzuri të gjithë intelektualët që kishin kurriz dhe përmbajtje kombëtare duke i zëvendësuar me proletarë analfabetë. Mbi 70 për qind të atyre që e nënshkruan Deklaratën e Pavarësisë në Vlorë ose i vrau, ose i burgosi. Me politikanë injorantë fatin e Shqipërisë ua

la në dorë jugosllavëve dhe serbëve, sovjetikëve (rusëve) dhe kinezëve duke zhveshur shqiptarët nga çdo vlerë njerëzore, kombëtare dhe politike pasojat e së cilës i vuajmë edhe sot. Në Kosovë ishte i njëjti yrnek, shqiptarët që flisnin shqip, në shërbim të Jugosllavisë dhe Serbisë ndiqnin, arrestonin dhe vrisnin patriotët e vërtetë shqiptarë që kundërshtonin mbetjen nën Serbi dhe donin të bashkoheshin me Shqipërinë. Denoncuesit dhe dëshmitarë kryesorë kundër patriotëve shqiptarë në proceset politike ishin pikërisht shqipfolësit që ishin integruar në strukturat represive jugosllave dhe serbe. Që nga koha e Marie Shllakut, Gjon Serreqit, Imer Berishës e deri te proceset gjyqësore kundër Bacë Adem Demaçit, denoncues, hetues, torturues dhe dëshmitarë ishin shqiptarë që kishin poste politike, ishin gazetarë, shkrimtarë dhe që paradoksi të jetë edhe më i madh, me ndryshimin e rrethanave u bënë patriotë deri në masën kur u bënë edhe biografë të autoriteteve të vërteta kombëtare. Sa të pafytyrë! Ata që kanë shkruar fjalë dhe fjalime të zjarra për Bacë Adem Demaçin ishin bashkëpunëtorë të UDB-së dhe dëshmitarë. Shiheni sot mendermethënë Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe na gjeni dikë në një të kaluar të pastër kombëtare, personale dhe familjare. Analizoni ku janë të sistemuar fëmijët dhe pasardhësit e tyre dhe krahasoni me familjet e patriotëve sakrifikues shqiptarë dhe fëmijët e tyre. Merreni përbërjen e qeverisë aktuale, të presidencës apo kuvendarëve, më gjeni aty patriotë apo sakrifikues për çështjen kombëtare. Ata që janë kinse trashëgimtarë të një trashëgimie kombëtare, sot janë antikombëtarë brutal dhe të egër. Prandaj edhe jemi ku jemi, po shkojmë ku nuk duhet të shkojmë. Edhe ne e kemi Grenellin tonë përkatësisht, jo mohuesin e Albin Kurtit, por himnizuesin e Kurtit, është Rexhep Qosja akademik e një Akademie që nuk ka bërë asgjë për Kosovën dhe çështjen kombëtare përveç që janë përjargur dhe përpyrrur të gjitha pushteteve, nga atij


jugosllav e deri te ky i Kurtit. Edhe pushteteve para regjimit të Kurtit, që nga përfundimi i luftës në Kosovë. Nuk ka asgjë më keq dhe më të mjerë se kur "Ajka e Kombit" i nënshtrohet injorancës së politikës dhe pushtetit. Ai popull nuk ka ardhmëri, përfundimisht pajtohet me mentalitetin e robit dhe nënshtrimit. Rexhep Qosja është shkencëtar dhe dijetar i madh, ndër të rrallët jo vetëm të shqiptarët. Si politikan është shumë i dëmshëm, nuk e kupton politikën, i mungon kurrizi dhe truri politik. Aty ku është ngatërruar në politikë e ka bërë shkrat, në kuptimin më të butë të fjalës! Asgjë të hairit nuk ka bërë në politikë përveç se ka përçarë në Shqipëri dhe Kosovë. Epërsinë intelektuale thuaja mbi të gjithë akterët që sot janë gjallë ose ata që janë duke e kaluar vetingun te Zoti, e ka shndërruar në arrogancë politike, i mbrojtur nga injoranca dhe pushteti politik, fizikisht e sidomos materialisht. Personalitetet me integritet të lartë dhe të pakundërshtueshëm njerëzor, kombëtar dhe moral, sa vlerë të shtuar e kanë neutralitetin. Para zgjedhjeve të 9 shkurtit 2025, Rexhep Qosja, nën përcjellje të lahtarit llaskuq doli me një ftesë urbi et orbi, si të ishte Papa i Shqiptarëve për ta votuar Albin Kurtin dhe LV-në. Pasi Albini dhe Qosja i fituan zgjedhjet ishte koha që Kurti të merret me qeverinë kurse Qosja me shkencën dhe letërsinë. Qosja nuk ndalet. Po e luan rolin e SPAK-ut në Kosovë, si Don Kishoti i Servantesit i ka caktuar rolin ta luftojë "Kartelin mafioz të Drejtësisë", në vend të Mullinjtë të Erës, i frymëzuar nga Sanço Pança i Mançës, Albin Baba dhe Dylqineja e Padrejtësisë, Lenka Quko. Rexhep Qosja nuk ka kapacitet profesional të merret me çështje të drejtësisë, kapaciteti profesional dhe moral po i shpenzohet dita - ditës. Vdekja po i vjen, "Jo prej syve të tillë por prej kapitullimit të pakusht para injorancës dhe arrogancës së pushtetit dhe politikës". Njëqind vjet vetmi apo njëqind vjet nënshtrim, ku shihni këtu dallimin. Autori është i njëjtë!

## Rexhep Qosja thotë se duhen shkarkuar dhe dënuar prokurorët dhe gjyqtarët e korruptuar

PRISHTINË, 27 SHKURT - Akademik Rexhep Qosja në "Facebook" ka shkruar se nëse nuk shkarkohen dhe dënohen prokurorët dhe gjyqtarët e korruptuar, nuk

mund të shërohet Kosova. "Nëse nuk i shkarkoni dhe dënoni prokurorët dhe gjyqtarët e korruptuar, nuk mund ta shëroni Kosovën. Ata e kanë formuar një

kartel (një diktaturë gjyqësore) dhe po mbrojnë korrupsionin sistematik që i solli në postet e tyre", ka shkruar Qosja në "Facebook".



# Dy vjet pas Marrëveshjes së Brukselit, Kosova dhe Serbia në prapakthim

PRISHTINË, 27 SHKURT - Në vend të zgjidhjes paqësore të mosmarrëveshjeve, sulm i armatosur në Banjskë; në vend të pranimit të simboleve kombëtare dhe respektimit të integritetit territorial, Serbia me rezervat e saj; në vend të anëtarësimit të papenguar të Kosovës në organizatat ndërkombëtare, grup punues për pengimin e saj; në vend të zgjidhjes për pozitën e serbëve në Kosovë dhe financimin nga Serbia, shfuqizim i dinarit dhe mbyllje e institucioneve serbe. Të gjitha këto janë hapa drejt shkëlqes së Marrëveshjes për Rrugën e Normalizimit të Marrëdhënies në mes të Kosovës dhe Serbisë, e cila u pranua dy vjet më parë - më 27 shkurt 2023 - nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vučić, në Bruksel.

Dokumenti, i cili në opinionin u njoh edhe si "Plani Franko-Gjerman" dhe kishte mbështetjen e ShBA-së, duhej të çonte në një marrëveshje gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënies në mes të Kosovës dhe Serbisë. Por të u ra dakord dhjetë vjet pasi të dyja palët nënshkruan Marrëveshjen e parë të Brukselit. E për t'u "siguruar" se do të zbatohet, ato u pajtuan edhe për Aneksin e Zbatimit gjatë një takimi në Ohër të Maqedonisë së Veriut më 18 mars 2023.

"Kemi një marrëveshje", tha me entuziazëm shefi i atëhershëm i politikës së jashtme të BE-së, Josep Borrell. Atëkohë i dërguari i posaçëm i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, tha se ishte "një marrëveshje e vështirë, por e nevojshme", e cila "do t'ia hapë dyert rajonit për të hyrë në një epokë të re paqeje".

Me marrëveshje, Kosova, mes të tjerash, u obligua ta formonte Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, ndërsa Serbia të mos e bllokonte anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare.

Marrëveshja parashikonte, gjithashtu, të drejta të barabarta për Kosovën dhe Serbinë, respektimin e integritetit territorial dhe paprekshmërinë e kufijve, njohjen e simboleve shtetërore dhe hapjen e përfaqësive diplomatike të Kosovës dhe Serbisë në selitë e qeverive të këtyre vendeve. Megjithatë, gjatë dy vjetëve të fundit në terren ndodhi pothuajse e kundërta e zbatimit.

"Radio Evropa e Lirë" iu drejtua Qeverisë së Kosovës, Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Presidencës së Serbisë, si dhe Bashkimit Evropian - që ndërmjetëson dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë - me pyetjen se kush është përgjegjës që marrëveshja ka mbetur vetëm një "germë e vdekur në letër", por prej asnjërit institucion nuk mori përgjigje. Në vend se "të gjitha mosmarrëveshjet ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit të zgjidhen ekskluzivisht me mjete paqësore dhe të ushtrohet përmbajtje nga

kërcënimet dhe përdorimi i forcës", siç parashihet në nenin 3 të marrëveshjes, në Banjskë të Zveçanit ndodhi një sulm i armatosur nga serbët, të cilët vranë një polic.

Në përlëshjen e armatosur që pasoi, u vranë edhe tre sulmues serbë.

Ngjarja ndodhi më 24 shtator 2023, rreth gjashtë muaj pas arritjes së marrëveshjes.

Përgjegjësinë e mori nënkryetari i atëhershëm i Listës Serbe, Millan Radoičiq, i cili më pas dha dorëheqje nga pozita në këtë parti - më e madhja e serbëve në Kosovë. Autoritetet e Kosovës ngritën aktakuzë kundër më shumë se 40 personave në rastin Banjska - në mesin e tyre dhe Radoičiq, i cili besohet se është i lirë në Serbi.

Kosova e cilësoi këtë sulm si terrorist dhe e akuzoi Serbinë se qëndron pas tij - gjë të cilën Beogradi e mohoi fuqishëm.

Komuniteti ndërkombëtar e dënoi ashpër sulmin dhe kërkoi që pjesëmarrësit të sillen para drejtësisë. "Ne mendojmë se ka pasur disa lidhje financiare dhe organizative me shtetin e Serbisë, por jemi duke e hetuar në tërësi", tha Escobar në një intervistë për Radion Evropa e Lirë në mars të vitit 2024.

Ish-zëvendësi i ndihmësit të sekretarit amerikan të Shtetit shtoi se ShBA-ja nuk kërkon nga Serbia ta hetojë këtë sulm, por të marrë përgjegjësi.

## Rezervat e Serbisë ndaj marrëveshjes

Në nenet 1 dhe 2 të Marrëveshjes për Rrugën e Normalizimit të Marrëdhënies thuhet se palët do të zhvillojnë marrëdhënie normale dhe të fqinjësisë së mirë, do t'i njohin dokumentet dhe simbolet kombëtare të njëra-tjetres dhe do ta respektojnë pavarësinë dhe integritetin e tyre territorial. Por, në dhjetor të vitit 2023, kryeministrja e atëhershme e Serbisë, Ana Bërnabiq, i dërgoi një letër BE-së, në të cilën Serbia shprehu rezervat ndaj marrëveshjes dhe aneksit të zbatimit të saj.

Në atë letër ajo theksoi se marrëveshja konsiderohet "e pranueshme vetëm në një kontekst që nuk ka të bëjë me njohjen de facto dhe de jure të Kosovës".

Përfaqësuesi i atëhershëm i BE-së në dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajčak, tha në shtator



të vitit 2024 se Serbia e ka tërhequr letrën.

Ndërkohë, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, insistoi në nënshkrimin e marrëveshjes si garanci për zbatimin e saj. Por, Bashkimi Evropian në disa raste theksoi se ajo është ligjërish e detyrueshme për të dyja palët, edhe pse nuk është nënshkruar.

## Bllokimi i Kosovës në Këshillin e Evropës

Neni 4 i Marrëveshjes për Rrugën drejt Normalizimit të Marrëdhënies përcakton se "Serbia nuk do ta kundërshtojë anëtarësimin e Kosovës në asnjë organizatë ndërkombëtare". Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vučić, dhe zyrtarë të tjerë të këtij vendi, thanë në disa raste se nuk do të lejojnë kurrë që Kosova të bëhet anëtare e Kombeve të Bashkuara.

Më 5 prill të vitit 2024, me urdhër të Vučićit, u formua grupi punues për koordinimin e aktiviteteve të organeve shtetërore, lidhur me "problemin e pranimit" të Kosovës në Këshillin e Evropës. Ai kërkoi që argument kryesor kundër pranimit të Kosovës në Këshillin e Evropës të ishte fakti që Prishtina nuk e ka formuar Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, e jo që "Kosova nuk është shtet", sepse kjo, siç tha, nuk do të kishte efekt, meqë shumica e vendeve anëtare të BE-së e kanë njohur Kosovën.

Më 16 prill Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës miratoi rekomandimin për pranimin e Kosovës në këtë organizatë, por vendet si Franca dhe Gjermania e kushtëzuan pranimin e saj me themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Meqë Kosova e refuzoi këtë kërkesë, anëtarësimi i saj në Këshillin e Evropës nuk u fut në agjendën e Komitetit të Ministrave të këtij organi më 17 maj 2024.

## Refuzimi i Kosovës për të bërë hapa drejt formimit të Asociacionit

Neni 7 i Marrëveshjes për Rrugën e Normalizimit të Marrëdhënies parasheh që komunitetit serb në Kosovë t'i sigurohet "nivel i duhur i vetëmenaxhimit dhe aftësi për të ofruar shërbime në fusha të caktuara, përfshirë mundësinë e mbështetjes financiare nga Serbia dhe një kanal të drejtpërdrejtë komunikimi me Qeverinë e Kosovës". Në tetor të vitit 2023, të dërguarit nga Pesëshja e Madhe - Bashkimi Evropian, Shtetet e Bashkuara, Franca, Gjermania dhe Italia - paraqitën një draft-statut për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë dhe në Serbi. Por, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, refuzoi ta dërgonte atë draft-statut për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese, që ishte hapi i parë drejt themelimit të Asociacionit.

## Në vend të Asociacionit, mbyllja e institucioneve serbe dhe heqja e dinarit

Statuti i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe parasheh zgjidhje për pozitën e komunitetit serb në Kosovë, rregullon mbrojtjen e të drejtave të tij, si dhe financimin nga Serbia.

Edhe pse nuk u formua, Kosova, në dhjetor të vitit 2023, miratoi një rregullore për ndalimin e transaksioneve të pagesave në dinarë, gjë që goditi komunitetin serb, i cili pranon pagesa të ndryshme nga buxheti i Serbisë - nga pagat deri te shtesat për fëmijë.

Nga janari i vitit 2024, ndërkaq, Kosova nisi edhe mbylljen e institucioneve që vepronin në kuadër të sistemit të Serbisë, me arsyetimin se puna e tyre ishte e

paligjshme. Këto vendime të Qeverisë së Kosovës u pritën me kritika të ashpra nga bashkësia ndërkombëtare, e cila i cilësoi "të njëanshme dhe të pakoordinuara".

Vendet perëndimore e kritikuan Kosovën që nuk ofroi zgjidhje alternative para se ta shfuqizonte dinarin dhe t'i mbyllte institucionet serbe.

## Mosrespektimi i marrëveshjeve të tjera të arritura

Në dy vjetët e fundit Bashkimi Evropian përsëriti se Kosova dhe Serbia nuk i kanë respektuar as marrëveshjet e tjera, edhe pse neni 10 i Marrëveshjes për Rrugën drejt Normalizimit të Marrëdhënies përcakton se "të dyja palët konfirmojnë obligimin e tyre për t'i zbatuar të gjitha marrëveshjet e mëparshme në dialog, të cilat mbeten të vlefshme dhe të detyrueshme".

Qeveria e Kosovës tha në mes të korrikut të vitit të kaluar se synon të hapë për trafik urën kryesore mbi lumin Ibër në Mitrovicë, e cila e ndan qytetin në jugun e banuar me shumicë shqiptare dhe në verin e banuar me shumicë serbe.

Kjo ide u kundërshtua fuqishëm nga BE-ja dhe vendet e Quint-it (ShBA-ja, Gjermania, Franca, Britania e Madhe dhe Italia), të cilat thanë se ura duhet të hapet ekskluzivisht në përputhje me marrëveshjet përkatëse, të arritura në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënies në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Kosova dhe Serbia ranë dakord për hapjen e urës mbi Ibër në vitin 2014, por më 2016 u ra dakord për një plan të ri zbatimi, me qëllim tejkalimin e mosmarrëveshjeve rreth interpretimeve të ndryshme që u bëheshin konkluzioneve të mëparshme. Ura duhej të hapet në vitin 2017, por në praktikë nuk ndodhi kurrë.

Misioni paqeruajtës i NATO-s, KFOR, pjesëtarët e të cilit janë urë, tha gjithashtu se vendimi për hapjen e urës për trafik duhet të merret në kuadër të dialogut. Qeveria e Kosovës, në fund, hoqi dorë nga synimi i saj.

Në anën tjetër, Qeveria e Serbisë më 28 tetor të vitit të kaluar i propozoi Parlamentit për miratim ligjin që parasheh gjykimin për të gjitha veprat e parapara me Kodin Penal të cilat janë kryer pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në shkurt të vitit 2008, si dhe ligjin që territorin e Kosovës ta shpallë zonë të mbrojtjes së veçantë sociale.

Bashkimi Evropian e cilësoi këtë iniciativë të Qeverisë së Serbisë si shkelje të marrëveshjeve të Brukselit dhe i bëri thirrje Beogradit zyrtar që ta rishqyrtonte miratimin e paralajmëruar të ligjeve. Ai kujtoi se obligimet e Serbisë dhe të Kosovës në lidhje me juridiksionin e autoriteteve gjyqësore kanë qenë të qarta që nga nënshkrimi i Marrëveshjes së parë të Brukselit për normalizimin e marrëdhënies në vitin 2013. Deri më tash këto ligje nuk kaluan në procedurë parlamentare në Serbi.

## Ambasada gjermane: Marrëveshja nuk është vjetruar

Ambasada gjermane në Kosovë tha se Marrëveshja për Rrugën e Normalizimit të Marrëdhënies ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe Aneksi për Zbatimin e saj nuk mund të vjetrohen.

Sipas saj, dokumentet mbeten të detyrueshme për të dyja palët dhe bazë për negociatat e mëtejshme. "Presim zbatim të plotë", thuhet në deklaratën dhënë "Radios Evropa e Lirë".

Ambasada gjermane pranoi se në dy vjetët e fundit ka pasur "përparim të kufizuar" në dialog, por se kjo "në asnjë mënyrë nuk i pakëson të arriturat dhe mirëkuptimet e ndërsjella, të përcaktuara me Marrëveshjen e Ohrit". "Serbia dhe Kosova kanë riafirmuar angazhimin e tyre ndaj Marrëveshjes së Ohrit në kontekstin e Planit të Rritjes të BE-së. Ne besojmë se ka një vull

të ri në dialog nën udhëheqjen e Komisionit të ri Evropian dhe përfaqësueses së lartë të tij, Kaja Kallas, së bashku me përfaqësuesin e sapoemëruar të posaçëm të BE-së, Peter Sorensen", thuhet në deklaratën e Ambasadës gjermane. "REL"-i kontaktoi edhe ambasadat e ShBA-së, Francës dhe Mbretërisë së Bashkuar për këtë temë, por nuk mori përgjigje.

## Portofoli i kredive të garantuara ka arritur në 850 milionë euro

PRISHTINË, 27 SHKURT - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka organizuar një takim me Besnik Berishën, drejtorin menaxhues të Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë (FKGK), për rolin e Fondit në lehtësimin e qasjes në financa dhe mbështetje të rritjes ekonomike.

Berisha ndau arritjet e FKGK-së, duke theksuar se portofoli i kredive të garantuara ka arritur në 850 milionë euro dhe shprehu besimin e tij se kjo shifër do të kalojë 1 miliard euro deri në fund të vitit. Ai elaboroi dritaret aktuale garantuese për gratë ndërmarrëse, startupet dhe investitorët e

diasporës dhe ftoi bizneset të japin sugjerime për mundësi të tjera garancie. Oda Amerikane mbetet e angazhuar për ta fuqizuar bashkëpunimin ndërmjet sektorit privat dhe institucioneve financiare për ta mbështetur rritjen dhe zhvillimin e bizneseve në Kosovë.



# Ngrihen çmimet e prodhimit dhe të importit në Kosovë



## **EPOKA ERE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 27 SHKURT - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Çmimeve të Prodhimit (IÇP) për tremujorin e katërt të vitit 2024. Sipas ASK-së, janë ngritur çmimet e prodhimit në tremujorin e katërt (TM4) 2024 krahasuar me tremujorin e katër të vitit 2023.

Më tutje thuhet se indeksi i tërësishëm i çmimeve të prodhimit në Kosovë u ngrit për 0,1 për qind ndërmjet TM4 2024 dhe TM3 2024, kurse krahasuar TM4 2024 me TM4 2023, çmimet e prodhimit u ngritën në një mesatare prej 8,5-përqindësh. "Çmimet e prodhimit në Kosovë u ngritën në një mesatare prej 0,1 % në mes TM4 2024 dhe TM3 2024. Ngritje më të mëdha sipas degëve të veprimtarive ekonomike vërehen te:

prodhimi i mjeteve motorike të (transportit), rimorkiove dhe gjysmë rimorkiove (12,8 %); prodhimi i mobilieve (8,4 %); grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë (3,2 %); përpunimi i produkteve ushqimore (0,8 %); prodhimi i pijeve (0,3 %); energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar (0,1 %) dhe prodhimi i produkteve kimike (0,1 %)", thuhet në njoftimin e ASK-së.

Ngritja u neutralizua nga rënia e çmimeve te: xeheroret dhe guroret e tjera (-5,2%); prodhimi i produkteve të fabrikuar metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve (-3,9%); nxjerrja e xehes së metalit (-3,2%); prodhimi i metaleve (-2,4%); prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës (-1,3%); dhe prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç

prodhimit i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara - thurëse (-0,1%). "Çmimet e Prodhimit në Kosovë u ngriten në një mesatare prej 8,5% në mes të TM4 2024 dhe TM4 2023. Ngritje më të mëdha sipas degëve të veprimtarive ekonomike vërehen te: energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar (20,6%); prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës (11,0%); prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t (10,5%); prodhimi i mobilieve (10,3%); prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës (8,8%); përpunimi i produkteve ushqimore (6,9%); grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë (6,8%); prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilieve: prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara - thurëse (5,5%); prodhimi i

produkteve kimike (4,4%); prodhimi i metaleve (3,8%); prodhimi i pijeve (3,6%); prodhimi i produkteve minerale jo metalike (1,6%); nxjerrja e xehes së metalit (1,2%); dhe prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës (1,0%)".

Ngritja u neutralizua nga ulja e çmimeve te: prodhimi i pajisjeve elektrike (-8,9%); xeheroret dhe guroret e tjera (-1,0%); prodhimi i produkteve të fabrikuar metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve (-0,9%); dhe prodhimi i mjeteve motorike të (transportit), rimorkiove dhe gjysmë rimorkiove (-0,8%).

Edhe çmimet e importit në Kosovë u ngrit për 0,1% në TM4 2024, krahasuar me TM3 2024. Krahasuar me TM4 2023 çmimet e importit u ngritën në një mesatare prej 0,5%. Ngritje më të mëdha të çmimeve sipas sektorëve ishin

te: lëkura dhe artikujt e saj (2,8%); pajisjet e makinerisë dhe pajisjet elektrike (1,9%); produktet bimore (1,5%); artikujt e ndryshëm të prodhuar (1,4%); tekstili dhe artikujt e tekstilit (1,1%); druri dhe artikujt e tij (1,0%); instrumentet optike, fotografike, matëse, medicinal, muzikorë dhe mekanizmat e orës (0,4%); mjetet e transportit (0,3%); letrat dhe artikujt e saj (0,3%); këpucët (0,3%); artikujt ushqimorë të përgatitur, pijet dhe duhani (0,2%); shtazët e gjalla dhe produktet e shtazëve (0,2%); dhe produktet minerale (0,1%).

Ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve sipas sektorit te: vajrat ushqyese (-3,2%); plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre (-2,6%); metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë (-1,6%) dhe artikujt e gurit, llaçit, produktet e qeramikës dhe të qelqit (-0,7%).

## Hoti: 2025-a nisi me rritje të faturave të tatimit në pronë

PRISHTINË, 27 SHKURT - Ish-kryeministri Avdullah Hoti ka thënë se viti 2025 ka nisur me rritje të tatimit në pronë. Në një postim në "Facebook", ai ka publikuar

fatura të vitit 2021 ku tatimi figuron të jetë mbi 100 euro, kurse në vitin 2025 i njëjti është 60 euro më shumë pra mbi 160 euro. "Viti 2025 nis me fatura të rritura të

tatimit në pronë. Në një rast konkret fatura është 60 % më e lartë krahasuar me vitin 2021. Pasojat e qeverisjes së mbrapshtë katërvjeçare po i vuajnë

qytetarët me rritje të tatimit në pronë, me shtrenjtim të energjisë elektrike dhe të shportës së konsumit të përditshëm", ka shkruar Hoti.





# RRËFIMI I AL PACINOS: UNË, COPPOLA, MARLON BRANDO DHE “KUMBARI” IM

Ajo që mendoj se audienca mori nga “Kumbari”, ajo që e përcolli dhe i dha vërtet ndikimin e tij, ishte kjo ide e familjes. Njerëzit u identifikuan me Korleonët, e panë veten tek ata dhe ndjenë një lidhje me personazhet dhe dinamikën e tyre si vëllezër e motra, prindër dhe fëmijë. Filmi kishte dramën dhe rrëfimin emocionues të Mario Puzos, magjinë e interpretimit të Coppolës dhe dhunën reale. Por, në kontekstin e asaj familjeje, gjithçka u bë diçka tjetër. Nuk ishin vetëm njerëzit nga qyteti që ndiheshin të lidhur me Korleonët—ajo ndjenjë familjariteti e shpërndau filmin në çdo cep të botës.

Marlon Brando tregoi shumë bujarë me mua, por nuk mendoj se e kurseu vetëm për mua, sepse e ndau me audiencën. Kjo ishte që e bëri interpretimin e tij kaq të paharrueshëm dhe të dashur. Të gjithë fantazojmë të kemi

nisur për në dhomën time të grimit, duke thënë me vete: “Epo, nuk isha dhe aq keq. Nuk kisha asnjë rresht për të thënë, asnjë detyrim. Isha në rregull.” Teksa po kthehesha, fillova të dëgjoja zërin e dikujt që po qante, gjë që mund ta prisje në një varrezë. Hodha sytë përreth, për të parë nga vinte zëri. Dhe atje, ulur mbi një varr, ishte Francis Ford Coppola, duke qarë si fëmijë. Qante pa u ndalur.

Askush nuk po i afrohej, ndaj shkova dhe e pyeta: “Francis, çfarë ke? Çfarë ndodhi?” Ai i fshiu sytë me mëngën, u ndal pak, më pa dhe tha: “Nuk do të më lejojnë të bëj një tjetër xhirim.” Ai kishte dashur të filmonte një tjetër skenë atë ditë, por nuk ishte lejuar. Edhe ai duhej t’i jepte llogari dikujt tjetër. Dhe ai e donte këtë aq shumë, sa që refuzimi e kishte lënduar thellësisht.

Asnjëherë nuk i dihet nëse një film do të jetë i madh. Di një gjë, nëse skenari është vërtet i



Siçili për herë të parë në jetën time. Nuk isha gati për këtë. M’u duk si një angari e madhe. Por sapo mbërrita, ndjeva një lloj energjie kozmike. Gjithçka më erdhi përpara, madje edhe gjëra që nuk i kisha përjetuar kurrë. Rrugët që më kishin sjellë deri këtu kishin nisur pikërisht këtu – çfarëdo që isha ose do të bëhesha, kishte një lidhje me këtë vend. Ishte një përvojë që të hapte sytë, të rriste vetëdijen dhe ishte krejtësisht themelore. Si aktor, gjithmonë je në kërkim të identitetit dhe gjërave me të cilat lidhet shpirti yt. Kur u ktheva nga ky udhëtim, nisa t’u them të gjithëve që duhet të shkojnë e të vizitojnë vendet nga vijnë familjet e tyre, të ndjekin rrënjët e tyre sa më larg që të mundën. Është një mënyrë për t’u lidhur me realitetin, një kujtesë që ke ekzistuar dhe vazhdon të ekzistosh.

Nuk njihja askënd në Siçili, dhe as njerëzit atje nuk më njihnin mua. Nuk e dinin çfarë roli po luaja tek “Kumbari”, madje as që e dinin se isha siçilian. Isha një aktor i panjohur, dhe të ishe i panjohur ishte kënaqësi. Nuk flisja me askënd. Nuk dija çfarë të thosha. Por kudo që shkoja, vendasit ishin kuriozë dhe shumë të sjellshëm me mua. Nuk kishin shumë, por ishin bujarë dhe plot hijeshi, dhe ata po ftonin një djalë nga filmi,

ose këdo tjetër, të vinte dhe të mangia (hante) me ta, në shtëpitë e tyre të vogla. Unë uleshja në heshtje dhe haja ushqimin që më ofronin.

Kur erdhi momenti për të xhiruar skenën e dasmës, ku Michael martohet me Apollonian në një ceremoni të bukur, po rrija aty me kostumin tim të leshtë, pranë Simonetta Stefanellit, e cila luante nusen, dhe një grup italianësh që nuk flisnin anglisht. Kjo nuk më dukej se ishte një skenë sfiduese për t’u xhiruar, por ja tek ishte Francis me një megafon në dorë, duke bërë treguesit: “Al, dua që të bësh tre gjëra. Së pari, shko atje dhe fol me njerëzit në skenë. Pastaj, kthehu prej, shko te nusja dhe kërce valsën me të. Më pas, shko bashkë me të te makina dhe largohu.”

Ja tek isha unë, Aktori Metodik, që i thashë: “Duhet të kuptosh, Francis, unë nuk di të flas italisht.” Ai tha: “S’ka problem, Al, sajo diçka.” Dhe unë pranova. Kamera ishte në distancë për një plan të mesëm, jo një plan të afërt, kështu që nuk do të dallohej tamam se çfarë po thosha. Pastaj, kur ai tha, “Shko dhe kërce valsën,” u ktheva nga Coppola dhe i thashë: “Por unë nuk di të kërcej vals.” Ai tundi kokën, më pa me inat dhe bërtiti: “Atëherë thjesht kërce me të, pastaj, kur të kesh mbaruar, shko te makina dhe largohu!” Ta kishit parë fytyrën e tij kur iu përgjigja: “Më fal, Francis, por nuk di as të ngas makinën.” Si mundej një djalë nga Bronksi të ngiste makinën, kur kishte përdorur metronë gjithë jetën? Unë e mora patentën e parë të shoferit në moshën tridhjetë e katër vjeç.

Në atë moment, Francis shpërtheu: “Pse të mora në punë? Çfarë di të bësh ti?” Unë i thashë: “Nuk e di nëse ka rëndësi, por di të thur shporta, kështu që me këtë do merrem kur të vijnë të më marrin me forcë.” Figurantët shpërthyen në të qeshura teksa e panë këtë shkëmbim të ndodhte para tyre.

Sot e kujtoj këtë skenë me

nostalgji. Ai ishte një regjisor që po bënte një film, dhe unë isha një aktor që nuk mund të bënte shumicën e gjërave që më kërkonte. Por unë vallëzova, fola italisht me njerëzit atje dhe zbrita kodrën, hipa në makinë dhe e ngava tre a katër metra. Kjo është arsyeja pse të gjithë i duam filmat. Gjithçka është e mundur.

Bënte shumë vapë aty në korrik. Të gjithë ishim të veshur me rroba leshi. Po xhironim një skenë që kërkonte një grup të madh figurantësh të rreshtoheshin në një rresht, kur u shpall pushimi për drekë dhe njerëzit filluan të shpërndaheshin. Asistenti i regjisorit, një djalë me përvojë të madhe nga Roma që po mbante nën kontroll figurantët, filloi t’u bërtiste siçilianëve – “Hej, kthehuni atje!” – sikur po fliste me gomerë...

Kjo më shqetësoi. Këta njerëz kishin duruar në mes të vapës që herët në mëngjes. Njëri prej burrave në rresht ngriti dorën, tha diçka në italisht dhe tregoi orën, sepse ishte dy e pasdites. Dhe romani i tha, në italisht: “Ti mbylle gojën dhe kthehu në rresht.”

Figuranti ishte një burrë i shkurtër, i dobët, me flokë gri dhe një fytyrë të hijshme. Mendoj se ishte në të gjashtëdhjetat. Kishte një modesti tek ai person. Thjesht ngriti supet dhe u largua. Braktisi filmin, që do të thoshte se nuk do të paguhej.

E adhurova. Imagjinova se si do të ishte të isha si ai. Çfarë guximi. Këta ishin njerëz të varfër, që paguheshin pak për të mbushur sfondin e filmit. Ky njeri nuk kishte para dhe po largohej sepse i kishte ardhur koha e drekës. Do të shkante diku dhe do të hante pak djathë dhe një copë frutë. Edhe unë e kisha pasur dikur atë liri. Por nuk doja të ndërroja vendet me të. Thjesht po e shijoj fantazinë që më frymëzoi. E pashë dhe mendova: Kjo është diçka me të cilën pajtohem. Në shpirt. Për mua, ai ishte një hero.

Pjesë nga autobiografia e Al Pacinos, “Sonny Boy” | Bota.al



dikë si Don Vito tek i cili mund të drejtohem. Ka kaq shumë njerëz që pësojnë padrejtësi në këtë jetë, por nëse ke një Godfather, ke dikë ku mund të shkosh dhe ai do të kujdeset për ty. Kjo është arsyeja pse njerëzit u ndjenë të lidhur me të në film.



Nuk ishte thjesht guximi dhe trimëria; ishte humanizmi që fshihej poshtë tyre. Prandaj ai duhej ta luante Viton si një figurë madhështore—madhësia e tij fizike, llaku në flokët e tij, pambuku në faqet. Godfather-i i tij duhej të ishte një ikonë, dhe Brando e bëri atë po aq ikonik sa Citizen Kane ose Superman, Julius Caesar ose George Washington.

Por Francis Ford Coppola kishte shumë peshë mbi supë, siç do ta mësoja kur po punonim për skenën e funeralit të Vitos. Ishte një skenë e madhe që e xhiruam në Long Island, e cila përfshinte një numër të madh të aktorëve dhe zgjati disa ditë. Dielli po perëndonte dhe dëgjoja “Stop! Mbaruam!” Më thanë se për atë ditë isha i lirë. Kështu që, natyrisht, isha i lumtur sepse do të shkoja në shtëpi dhe do të shijoj pak kohë të lirë. Isha

mirë – dhe Mario e Francis shkruan një skenar të mirë – ka gjithmonë një shans. Një aktor hyn dhe luan rolin e tij, por filmi është i tëri në atë që ndodh më pas, në mënyrën se si një montazhier e ndërton dhe si regjisorin arrin të krijojë rrëfimin. Por atje, në atë varrezë, mendova: Nëse ky është lloji i pasionit që Francis, atëherë diçka këtu po funksionon. E dija që isha në duar të sigurta.

Realizimi i filmit më çoi në





## Rexhbeçaj për 'FIFA.com': Për Kosovën çdo gjë është e mundur

**PRISHTINË, 27 SHKURT** - Kthimi në rrënjët e tij ka qenë një udhëtim i gjatë për Elvis Rexhbeçaj. Edhe pse ai ka lindur në fshatin Gjonaj, i cili njihet në Kosovë, në vitin 1997 ai dhe familja e tij u larguan për në Gjermani kur ishte vetëm dy vjeç. Ai u rrit në atdheun e tij të adoptuar dhe kaloi 12 vjet me Wolfsburgun nga viti 2010 deri në vitin 2022, duke kaluar nëpër të gjitha grupmoshat dhe duke u bërë një lojtar i ekipit të parë. Më pas, në vitin 2022, ai kaloi në Augsburg, por ndoshta ndryshimi më i madh në jetën e tij erdhi në fund të vitit të kaluar. Me ndryshimin e ligjit gjerman që lejonte shtetësinë e dyfishtë, Rexhbeçaj vendosi se do të luante për Kosovën dhe bëri debutimin e tij në kombëtare në shtator të vitit të kaluar, në moshën 26-vjeçare, duke luajtur 90 minuta në një humbje ndaj Rumanisë në Ligën e Kombeve të UEFA-s. Me synimin për të luajtur sa më shumë ndeshje dhe për ta çuar Kosovën në një finale globale për herë të parë në Kupën e Botës FIFA 2026, mesfushori u ul me FIFA-n për të diskutuar këto objektiva, jetën e tij të hershme në skenën ndërkombëtare, marrëdhënien me trajnerin Franco Foda dhe shumëçka tjetër.

**FIFA:** Ju u inkuadruat për herë të parë me Kosovën në shtator të vitit të kaluar në Ligën e Kombeve të UEFA-s. Sa kohë keni pritur për atë çast dhe si ndodhi kjo?

**Elvis Rexhbeçaj:** Kam pasur kontakt të parë me Franco Fodën në fillim të vitit të kaluar. Sapo kaloi ligji që lejonte shtetësinë gjermane të merrnin shtetësinë e dyfishtë, nuk kishte asnjë dyshim që do të luaja për Kosovën. Që nga ai moment, natyrisht që isha i gatshëm të bëja debutimin tim, dhe më në fund arrita ta bëja atë përballë Rumanisë në shtator.

**FIFA:** Si e ndjetë të rreshtoheshit në mëmëdhe, të dilnit përpara popullit tuaj në një ndeshje në shtëpi?

**Elvis Rexhbeçaj:** Kam pritur kaq gjatë dhe familja ime, e dashura ime dhe ajo që duket si e gjithë popullsia e fshatit tim të lindjes ishin aty, të gjithë me buzëqeshje në fytyrë, kështu që ishte padyshim shumë speciale. Të luash për klubin është një gjë, por përfaqësimi i vendit tënd është diçka krejtësisht tjetër.

**FIFA:** Ju keni një rol kyç në mesfushë nën udhëheqjen e Fodës. Si ishin ato biseda të para me të? Çfarë udhëzimesh ju dha ai?

**Elvis Rexhbeçaj:** Franco dhe unë patëm një bisedë të gjallë në fillim dhe, vetëm nga ajo bisedë, mund ta kuptoja se ai vërtet donte që unë të isha pjesë e ekipit dhe kishte një rol të rëndësishëm të parashikuar për mua. Ai përshkroi filozofinë e tij të futbollit. Po ashtu, erdhi të më shikonte në një seancë stërvitore këtu në Augsburg. Fatkeqësisht, pësova një lëndim, gjë që më pengoi të bashkohesha me ekipin kombëtar gjatë verës. Edhe atëherë, ai më la një përshtypje të mirë me mënyrën se si më mbështeti, gjë që më tregoi se ishte i sinqertë.

**FIFA:** Keni ndihmuar Kosovën të kualifikohet për 'play-off'-in e Ligës së Kombeve duke mbyllur edicionin në vendin e dytë në Grupin 2 të Ligës C. Sa jeni i kënaqur me fillimin e jetës suaj në skenën ndërkombëtare?

**Elvis Rexhbeçaj:** Ishim në një grup emocionues, por të vështirë që përfshinte edhe Rumaninë, e cila mori vendin e parë. U përshtatëm mirë si ekip dhe e morëm secilin ndeshje një nga një, gjithmonë duke kërkuar të marrim sa më shumë mundësi nga çdo ndeshje. Duke shikuar pas, kujtoj që kemi bërë



disa paraqitje të kompletuara dhe të arrira, kështu që mund të marrim zemër nga kjo.

**FIFA:** Ju do të përballeni me Islandën në 'play-off' në mars. Si e vlerësoni mundësinë tuaj?

**Elvis Rexhbeçaj:** Ne duam të vazhdojmë nga aty ku e lamë në fazën e grupeve duke kontrolluar posedimin e topit dhe duke diktuar lojën, dhe në fund të dalim fitues për t'u ngjitur në Ligën B. Nuk do të jetë e lehtë: Islanda është një ekip me përvojë dhe ka disa lojtarë të klasës botërore, por kemi mundësi nëse luajmë në nivelin më të lartë të mundshëm.

**FIFA:** Kualifikueset e Kosovës për Kupën e Botës FIFA 2026 fillojnë në shtator. Çfarë mendoni për grupin tuaj, i cili ju përball me Zvicrën, Suedinë dhe Slloveninë?

**Elvis Rexhbeçaj:** Është një grup shumë i barabartë ku çdo ekip mund të mposhtë çdo ekip tjetër. Ne e kemi dëshmuar disa herë që mund të mbajmë nivel të lartë kundër kombëtareve më të mëdha, dhe nëse jemi në formën tonë më të mirë dhe gjejmë ritmin, çdo gjë është e mundur, madje edhe për një ekip si ne, që konsiderohet e nënvlerësuar.

**FIFA:** Çfarë do të jetë qasja e ekipit për kualifikueset?

**Elvis Rexhbeçaj:** Ne duam të shkojmë përpara dhe kemi një objektiv të qartë përpara: të arrijmë në Kupën e Botës. Do të mund të realizojmë këtë qëllim vetëm nëse tregojmë pasion dhe bashkëpunim si ekip, ku çdo lojtar punon për njëri-tjetrin.

**FIFA:** Çfarë do të thotë për ju dhe për vendin tuaj kualifikimi në Kupën e Botës?

**Elvis Rexhbeçaj:** Kam vështirësi ta shpreh me fjalë se sa e madhe do të ishte kjo për vendin dhe për mua personalisht. Mendoj se përfaqësimi i vendit tuaj në Kupën e Botës, edhe nëse është vetëm një herë, është kulmi i suksesit për çdo futbollist. Do të ishte diçka fantastike, megjithatë e dimë që ende ka shumë për të kaluar.

**FIFA:** A ka ndonjë edicion të Kupës së Botës, ose ndeshje specifike, që ju kujtohet?

**Elvis Rexhbeçaj:** E kam ndjekur këtë garë për aq sa kujtoj për veten, por turneu që më vjen menjëherë në mendje është ai i Gjermanisë në vitin 2006. Atëherë isha fëmijë dhe i pasionuar pas Botërorit; nuk

mund ta besoja kur rrugëtimi fantastik i Gjermanisë mbaroi në gjysmëfinale kundër Italisë. Turneu i vitit 2014, kur Die Mannschaft fitoi titullin, ishte padyshim mahnitës gjithashtu.

**FIFA:** Kthehemi te futbollit i klubit, ju jeni në Augsburg që nga viti 2022. Sa i kënaqur jeni me zhvillimin tuaj që pas kalimit atje?

**Elvis Rexhbeçaj:** Jam shumë i kënaqur në Augsburg dhe kalimi ka dhënë rezultat në çdo aspekt. Kam qenë një pjesë e ekipit sa herë që kam qenë në formë, dhe bëj gjithçka që mundem për të kontribuar. Nga pikëpamja personale, kam mbetur besnik ndaj vetes dhe vazhdoj të rritem. Kjo ndihmohet nga fakti që ndihem si në shtëpi këtu; kam ndjesinë se jam këtu për një periudhë afatgjatë.

**FIFA:** Augsburgu aktualisht është në mesin e tabelës në Bundesliga, por ju nuk keni humbur në tetë ndeshjet tuaja të fundit. Në bazë të kësaj serie, a po shikoni tashmë më lart në tabelë?

**Elvis Rexhbeçaj:** Padyshim që po kalojmë një periudhë shumë të mirë dhe kemi krijuar një distancë mes nesh dhe zonës më të ulët të tabelës. Megjithatë, duhet të mbajmë këmbët në tokë; gjërat mund të ndryshojnë në një moment në Bundesliga, kështu që nuk mund të lejojmë që të humbasim përqendrimin. Duhet të qëndrojmë të fokusuar dhe të mos ngelim te tabela, por ta marrim çdo ndeshje si vjen dhe të vazhdojmë të ndërtojmë mbi atë që kemi bërë.

**FIFA:** Cilat janë objektivat dhe qëllimet tuaja personale dhe si ekip deri në fund të sezonit?

**Elvis Rexhbeçaj:** Dua të vazhdoj të bëj gjithçka që mundem për të na ndihmuar të arrijmë sukses dhe për të vazhduar të përparojmë si ekip.

## Prishtina dhe Drita kualifikohen në gjysmëfinale të Kupës

**PRISHTINË, 27 SHKURT (ER)** - Prishtina dhe Drita janë dy skuadrat e radhës që e kanë kompletuar kualifikimin në gjysmëfinale të Kupës së Kosovës në futboll. Prishtina e mposhti rivalin e vjetër, Vëllaznimin, me rezultat 0-4. Në pjesën e parë golin e parë e shënoi Yakubu, kurse në pjesën e dytë kryeqytetasit ishin skuadër edhe më e mirë dhe në këtë mënyrë shënuan edhe tre gola të tjetër për rezultatin final

0-4. Golat i shënuan Bytyqi, Raçi e Shillova, ndërsa kuqezinjve iu anulua goli i Osman Mëziut në pjesën e parë përmes sistemit VAR. Edhe Drita ka shënuar fitore bindëse në përballje me Prishtinën e Re (0-4). 0-2 u mbyll pjesa e parë e ndeshjes, kurse shënues ishin Broja dhe Selmani, kurse në pjesën e dytë gjilanasit i shënuan edhe dy gola të tjetër me anë të Manajt dhe Zulfiut. Kualifikimin në

gjysmëfinale të mërkurën e kanë siguruar edhe skuadra e Llapit dhe ajo e Drenicës. Llapi këtë sukses e arriti falë fitores në çerekfinale kundër Malishevës me rezultat 1-0. Ndërsa Drenica arriti që në stadiumin "Bajram Aliu" ta mposhtë skuadrën e Superligës, Ferizajn (1-0). Trofeu i Kupës është mjaft i lakmuar për klubet e Kosovës, pasi fituesi i kësaj gare e siguron pjesëmarrjen në gara evropiane.



## Iu drejtua bankinës së Galatasarayt me frazën “kërceni si majmunë”, dënohet Mourinho

STAMBOLL, 27 SHKURT - Katër ndeshje pezullim për Jose Mourinhon. Ky është vendimi i Federatës Turke të Futbollit pas polemikave të forta që shpërthyen pas derbit të Stambollit mes Fenerbahçes dhe Galatasarayt. Klubi kampion në fuqi e akuzoi “Special One” për racizëm, pasi ai iu drejtua bankinës së

Galatasarayt me frazën “kërceni si majmunë”. Trajneri portugez është pezulluar dy ndeshje për këtë deklaratë të dyshuar si raciste, dhe dy të tjera për fjalët e drejtuara ndaj gjyqtarit të katërt, të cilit i sugjeroi “të merrte shembull nga arbitri Vincic”, slloveni që ishte caktuar kryesor për këtë sfidë. Në konferencën për shtyp,

Mourinho kishte deklaruar për kundërshtarit se “kërcenin si majmunë”, duke iu referuar një proteste të bankinës së Galatasarayt në minutat e para të ndeshjes. Një frazë pa dyshim e papërshtatshme dhe që, ndoshta, nuk kishte qëllim diskriminues, por Federata Turke e Futbollit vendosi të veprojë ashpër: “Special One”

është pezulluar për 4 ndeshje. Në vendimin e federatës ka ndikuar edhe një episod tjetër: Mourinho pranoi në konferencë se kishte shkuar në dhomën e gjyqtarëve pas ndeshjes dhe i ishte drejtuar gjyqtarit të katërt turk me fjalët: “Nëse ti do të ishe gjyqtar kryesor, do të ishte një katastrofë”.



## Ministria e Sportit: Asnjë kontratë ekzistuese për stadiumet e futbollit nuk është anuluar

PRISHTINË, 27 SHKURT - Ministria e Sportit ka dalë me një sqarim publik rreth raportimeve se kjo ministri i ka anuluar tre tenderë në vlerë totale prej 37 milionë eurosh të cilat lidhen me punët stadiumet në Gjilan, në Pejë e në Mitrovicë.

“Reporterit” raportoi sot se tenderët që janë anuluar janë ai për ndërtimin e stadiumit të qytetit në Pejë me vlerë të parashikuar 19 milionë euro, tenderi për renovimin e stadiumit të qytetit në Gjilan me vlerë 15 milionë euro si dhe ai për renovimin e stadiumit “Adem Jashari” në Mitrovicë me vlerë të parashikuar të kontratës 3 milionë euro, duke sjell dokumente, duke pretenduar se janë publikuar gabimisht nga MKRS-ja. Kjo e fundit doli me sqarim publik sot, duke i hedhur poshtë këto pretendime. “Sqarim publik. Lidhur me



raportimet e fundit të mediave për anulimin e procedurave për stadiumin e Pejës, Mitrovicës dhe Gjilanit, sqarojmë se ato nuk janë anuluar. Sa i përket stadiumeve në Gjilan dhe Pejë, proceset janë në fazën e vlerësimit si procedura të rregullta dhe MKRS do të dalë

me rezultate në ditët në vijim. Po ashtu, sqarojmë se asnjë kontratë ekzistuese nuk është anuluar. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në krye me Hajrulla Çekun, ka anuluar tre tenderë në vlerë totale prej 37 milionë euro, që lidhen me punët nëpër stadiume”, ka njoftuar Ministria e Sportit.

## Befasohet Bostoni, Detroiti mposht kampionët

BOSTON, 27 SHKURT - Të tjera sfida emocionuese dhe shumë surpriza në sfidat e mbrëmjes së NBA-s të zhvilluara të mërkurën në mbrëmje. Befasinë më të madhe e dhuruan kampionët në fuqi të Boston Celticsit, të cilët u mundën nga Detroiti me shifrat 117-97. 27 pikët e Tatumit ishin të pavlefshme për Celticsin, pasi Pistoni i udhëhequr nga Beasley me 26 pikë dhe Cunningham me 21 ishin të papërmbajtshëm, duke i shkaktuar Bostonit humbjen e 17 sezonale. Suksesi i ngushtë, por i rëndësishëm për New York Knicksun që theu Philadelphia me shifrat 110-105. Përcaktues për vendësit ishte Brunsonu falë 34 pikëve e 7 asistimeve të dhuruara. Tjetër sukses për kryesuesit e Perëndimit,



Oklahoman, të cilët mposhtën 121-129 Brooklyn në transfertë. Për miqtë dallimin diferencën e bëri i zakonshmi Shai Aleksander me kanadezin që realizoi 27 pikë. Fitore e rëndësishme edhe për Los Angeles Clippersin, me kalifornianët që triumfuan jashtë fushës 117-122 ndaj

Chicago Bullsit. James Hardeni ishte më i miri në parket me 30 pikë dhe 6 asistime. Fitore ndërkohë arriti edhe Miami Heat, me skuadrën nga Florida që mposhti me shifrat 131-109 Atlanta Hawks. Taylor Herro realizoi një double double për vendësit falë 24 pikëve dhe 10 asistimeve.

## Ronaldo: CR7 jo më i miri në histori, ja 10-shja më e mirë

Debati se kush është futbollisti më i mirë i të gjitha kohëve vazhdon të ngjallë opinione të ndara dhe këtë herë Ronaldo Nazario ka vënë në pikëpyetje fjalët e Cristiano Ronaldos. Braziliiani, dy herë kampion i Kupës së Botës, e ka pranuar madhështinë e yllit portugez,

por nuk ndan pretendimin e tij për të qenë lojtari më i kompletuar dhe më i madhi i të gjitha kohëve. Për të, sulmuesi i Al-Nassrit meriton një vend në mesin e elitës, por jo në kulmin absolut të futbollit. “Cristiano Ronaldo ka pasur një karrierë fantastike. Ai ka bërë gjëra të

mrekullueshme, duke përfshirë ndryshimin e pozicionit nga anësori i majtë në sulmues qendror. Dhe kjo nuk është një gjë e lehtë. Është e sigurt që ai është një nga më të mirët në historinë e futbollit. Më i miri? Nuk jam dakord. Por unë e respektoj pozicionin e tij.

Ai është ndër më të mirët në histori. Do të thosha në top dhjetëshen”, ka thënë Ronaldo. Braziliiani e përjashton veten nga gara: “Nuk më pëlqen të flas për këtë. Mendoj se njerëzit kanë një opinion shumë të lartë për veten. Preferoj që njerëzit të flasin për

situatën time, kush jam dhe çfarë kam bërë”. 10-shja më e mirë sipas ish-yllit brazilian: “Pele në vendin e parë, Maradona dhe Messi së bashku në të dytin. Më pas një seri lojtarësh: Zico, Romario, Cristiano Ronaldo, Van Basten, Figo, Rivaldo”.

### SHKURT

#### Presidenti i Empolit: Ismajli i rëndësishëm, rikuperimi i tij solli produktivitet

Empoli eliminoi nga Kupa e Italisë, Juventusin, teksa një pjesë loje luajti edhe Ardjan Ismajli. Presidenti i Empolit, Fabrizio Corsi, vlerësoi në maksimum mbrojtësin shqiptar, Ismajli. “Jemi mbi re, le të marrim më të mirën dhe ta gjejmë besimin për mbylljen e këtij sezoni të vështirë. Kemi rikuperuar dy lojtarë të rëndësishëm si Ismajli dhe Marianuçi. Dhe kjo solli të mirat e veta pas një periudhe të vështirë. Tani problemi është ta ruajmë mentalitetin dhe ta harrojmë mbrëmjen e djeshme”, ka thënë Corsi.

#### Motta pas eliminimit nga Kupa: Ndihej i turpëruar

Brenda javës Juventusit u jep lamtumirën dy kompeticioneve, Ligës së Kampionëve dhe Kupës së Italisë. “Motta, vendi i katërt nuk mjafton më. Në fund të sezonit mund të shkarkohet”, shkruan “La Gazzetta”. I ashpër pas ndeshjes u shfaq Thiago Motta, i vetëdijshëm se ky eliminim rëndon shumë: “Ndihej i turpëruar. Kemi bërë një pjesë të parë të turpshme, shpresoj që edhe lojtarët të kenë këtë ndjesi, këto emocione. Gabova unë, me sa duket nuk ua kam shpjeguar si duhet lojtarëve rëndësinë e këtij takimi. Është vetëm faji ynë që nuk jemi në gjysmëfinale, ata e merituan. Shpresoj që kritikata të jenë të forta. Duhet të kërkojmë falje, kemi prekur fundin”. Strategu i njohur rrezikon shkarkimin pasi bardhezinjtë, pavarësisht prej investimeve në merkato, kanë zhgënjyer në fushë.

#### Rummenigge: Leverkuseni llogaritet favorit, por Bayerni kualifikohet tutje

Legjenda e Bayern Munchenit, Karl-Heinz Rummenigge, ka folur për ndeshjen e Bayernit ndaj Bayer Leverkusenis në Ligën e Kampionëve. Ai ka thënë se Leverkuseni llogaritet si favorit, por do të jetë skuadra “bavareze” ajo që do të kualifikohet tutje. “E dini se përse jam optimist në këto dy ndeshje? Të gjithë konsiderojnë Leverkusenin favorit. Unë i njoh mirë lojtarët tanë dhe e di se sa të bezdisur janë nga ky fakt. Ata janë edhe më të motivuar për t’u përballur me vështirësitë, por mendoj se do të kalojmë për më tej. Në javët në vazhdim na presin takime mjaft delikate, por jam i qetë pasi në fund të sezonit pres të festojmë tituj”, ka thënë Rummenigge.







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



**MEKA**  
HALAL FOOD

**TRADITË QË NGA**

**1992**

